Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0754

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga, Isa Hasani-Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "AWA" SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Akademia e Kosovës për Siguri Publike në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Pajisje Elemente Sportive për Sallën Edukative Fizike në AKSP" me numër të prokurimit "214-23-7609-1-2-1", me 09/01/2024, mori:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e OE "Awa" Sh.p.k me nr. 2023/0754, e datës 02/10/2023, kundër "Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues" AK- Akademia e Kosovës për Siguri Publike, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Pajisje Elemente Sportive për Sallën Edukative Fizike në AKSP" me numër të prokurimit "214-23-7609-1-2-1".

2.Mbetet në fuqi "Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues" datës, 15.09.2023, i Autoritetit Kontraktues, Akademia e Kosovës për Siguri Publike, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "214-23-7609-1-2-1".

3.Konfiskohen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës ndaj e Operatorit Ekonomik "Awa" Sh.p.k, konform nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP-së dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Me 24.07.2023, Akademia e Kosovës për Siguri Publike në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me: "Furnizim me Pajisje Elemente Sportive për Sallën Edukative Fizike në AKSP" me numër të prokurimit "214-23-7609-1-2-1". Ndërsa me datën 15.09.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e

Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë N.T.G "Blendi" O.P - Prishtinë.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 29,500.00 €.

Me 20.09.2023, OE "Awa" Sh.p.k, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me datën 22.09.2023 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 02.10.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Awa" Sh.p.k, me nr. 754/23 për lidhur me aktivitetin: "Furnizim me Pajisje Elemente Sportive për Sallën Edukative Fizike në AKSP" me numër të prokurimit "214-23-7609-1-2-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Awa " Sh.p.k, janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): Ankuesi pretendon se "AK-Zyra e prokurimit gjatë vlerësimit te ofertave për ketë aktivitetit te prokurimit nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/1--042 1 ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/1--237, Ligjin Nr. 05/1--068 dhe Ligjin Nr. 05/1--092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartcekura dhe Udhëzimin operativ për prokurim publik. AK/ Akademia e Kosovës për Siguri Publike me 15.09. ka nxjerrë njoftimin mbi vendimin e AK, kompania jone është eliminuar me arsyetimin se na mungon autorizimi i prodhuesit. AK para se te vendos për eliminimin e ofertës sonë ka mund te kërkojë sqarime shtese për autorizim, ne posedojmë autorizimin e prodhuesit dhe është lëshuar para datës se aplikimit për projektin ne fjale. Për shkak te gabimit teknik gjate dorëzimit te ofertës nuk është ngarkuar autorizimi ne e-prokurim, te dokumentet e ofertës kemi dorëzuar një file tjetër dokumentet dhe autorizimi për ofertim dhe personi përgjegjës ne administrate i cili ka dorëzuar ofertën ka menduar se ne këto dokumente ka bashkangjitur autorizimin e lëshuar nga prodhuesi. AK duke u thirrur ne nenin 72.3 te LPP-se dhe nenin 10.1 te udhëzuesit për prokurim publik para se te vendos për eliminimin e kompanisë sonë ka mund te kërkoje sqarime shtese autorizimin. Citoj nenin 72.3 te LPP-se 3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Citoj nenin 10.1 te RRUOPP Mungon licenca Mund të kërkohen informata sqaruese 66. Mungon certifikata ISO Mund të kërkohen informata sqaruese 69.Duke mare parasysh se vlerësimi i ofertave ka zgjatur nga data 18.08. deri me 15.09.AK ka mund te sqaroje këtë detaj para se te eliminoje ofertën tone. autorizimin mare parasysh dhe faktin se jemi oferta me e lire e dorëzuar ne ketë aktivitet te prokurimit dhe AK ne këtë forme do te kursente paranë publike përkatësisht buxhetin e AKSP për 3004.00euro.AK ne përgjigje te kërkesës për ri-shqyrtim ka cekur se kompania jone nuk ka interes material-juridik nga ky projekt por vetëm jemi duke e prolonguar projektin, ky konstatim i AK nuk qëndron

kompania jone ka dorëzuar ofertën me te lire për këtë aktivitet te prokurimit dhe synon te nënshkruaje kontrate me AK kjo është dhe arsyeja e kërkesës për rishqyrtim, AK para se te eliminoje ofertën e kompanisë sonë është dashur qe konform dispozitave ligjore te lartcekure te kërkoje sqarime shtese. Ne nuk kemi pretendime ankimore ndaj OE tjerë pjesëmarrës mirëpo po kërkojmë te na lejohet e drejta jone pasi që jemi oferta me e tire për këtë aktivitet te prokurimit dhe nuk qëndron pretendimi i AK se kemi synim prolongimin e projektit."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "Awa" Sh.p.k, konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 52, 59, 60, 69, 72 të LPP-së si dhe Neni 10.1 i RRUPP nr. 001/2023. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, të anulohet vendimi i AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit si dhe lënda të rikthehet ne rivlerësim.

- *Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 09.10.2023 ka autorizuar eksperten shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 754/23, ndërsa me datë 20.10.2023 është dorëzuar raporti i ekspertes shqyrtuese me nr. 2023/0754 me rekomandimet si në vijim: "*Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim*."

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertes shqyrtuese, ndërsa OE ka deklaruar se pajtohet me raportin e ekspertes shqyrtuese.

Lidhur me pretendimet e OE "Awa" Sh.p.k, eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0754 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): "Akademia e Kosovës për Siguri Publike me 15.09. ka nxjerrë njoftimin mbi vendimin e AK, kompania jone është eliminuar me arsyetimin se na mungon autorizimi i prodhuesit. AK para se te vendos për eliminimin e ofertës sonë ka mund te kërkoje sqarime shtese për autorizim, ne posedojmë autorizimin e prodhuesit dhe është lëshuar para datës se aplikimit për projektin ne fjale. Për shkak te gabimit teknik gjate dorëzimit te ofertës nuk është ngarkuar autorizimi ne e-prokurim, te dokumentet e ofertës kemi dorëzuar një file tjetër dokumentet autorizimi për ofertim dhe personi përgjegjës ne administrate i cili ka dorëzuar ofertën ka menduar se ne këto dokumente ka bashkangjitur autorizimin e lëshuar nga prodhuesi. Sqarim i Ekspertit; Gjatë verifikimit të shkresave të lëndës eksperti ka verifikuar që OE ankues ka prezantuar një autorizim nga Kompania Vlera Sport LTD Sh.p.k me seli në Fushë Kosovë, e cila ka autorizuar kompaninë AWA Sh.p.k që të ofertoj për projektin në fjale. Andaj, rekomandoj që ky pretendim i ankesës të aprovohet dhe AK, në këtë rast mundet sipas Nenit 66, si dhe Udhëzuesit Nr. 001/2023, të kërkojë sqarime informata sqaruese për autorizim. AK duke u thirrur ne nenin 72.3 te LPP-se dhe nenin 10.1 te udhëzuesit për prokurim publik para se te vendos për eliminimin e kompanisë sonë ka mund te kërkojë sqarime shtese autorizimin. Citoj nenin 72.3 te LPP-se 3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Citoj nenin 10.1 te RRUOPP Mungon licenca Mund të kërkohen informata sqaruese 66 Mungon certifikata ISO Mund të kërkohen informata sqaruese 69. Duke mare parasysh se vlerësimi i ofertave ka zgjatur

nga data 18.08. deri me 15.09. AK ka mund te sqaroje ketë detaj para se te eliminoje ofertën tone. Sqarim; Eksperti shqyrtues mendon që kjo pik e ankesës aprovohet si e bazuar duke ju referuar Nenit 69 të LPP-së, si dhe Udhëzuesi Nr. 001/2023 për Prokurim Publik pika 10.1, kur Mungon certifikata ISO, mund të kërkohen informata shtese nga autoriteti kontraktues. Neni 1- Qëllimi dhe neni 6 i LPP-se- Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti obligon autoritetit kontraktuese qe fondet publike te shpenzohen ne mënyrë sa me racionale dhe ekonomike, AK: konform nenit 72.3 te LPP-se dhe RRUOPP para se te vendos për eliminimin e ofertës sonë ka mund te kërkojë sqarime shtese autorizimin mare parasysh dhe faktin se jemi oferta me e lire e dorëzuar ne ketë aktivitet te prokurimit dhe AK ne ketë forme do te kursente paranë publike përkatësisht buxhetin e AKSP për 3004.00euro. AK ne përgjigje te kërkesës për ri-shqyrtim ka cekur se kompania jone nuk ka interes material-juridik nga ky projekt por vetëm jemi duke e prolonguar projektin, ky konstatim i AK nuk qëndron kompania jone ka dorëzuar ofertën me te lire për ketë aktivitet te prokurimit dhe synon te nënshkruajë kontrate me AK kjo është dhe arsyeja e kërkesës për rishqyrtim, AK para se te eliminoje ofertën e kompanisë sonë është dashur qe konform dispozitave ligjore te lartcekura te kërkojë sqarime shtese. Ne nuk kemi pretendime ankimore ndaj OE tjetër pjesëmarrës mirëpo po kërkojmë te na lejohet e drejta jone pasi qe jemi oferta me e lire për këtë aktivitet te prokurimit dhe nuk qëndron pretendimi i AK se kemi synim prolongimin e projektit. Sqarim i Ekspertit lidhur me pretendimet ankimore të OE; Eksperti Shqyrtues në lidhje me pretendimet ankimore për mungesën e autorizimit të prodhuesit, si dhe mos prezantimit të certifikatës ISO, sipas kërkesave të AK. Rekomandohet që për këto pika të ankesës të pranohen si të bazuara në këtë raste dhe AK, duhet që ti shterr të gjitha mundësit, para se ta eliminoj OE më të lirë, si të pa përgjegjshëm, duke ju referuar nenit 72, pika e 3; Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Pra në këtë rast Autoriteti Kontraktues të veprojë në baze të Ligjit për Prokurim Publik si dhe Rregulloreve të Prokurimit Publik që janë në fuqi, duhet të kërkojë sqarime për këto dy pretendime para se ta eliminoj OE".

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor. Në ketë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues vlerëson se raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit.

Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues me qellim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, ka administruar si prova: Raportin e Ekspertit Shqyrtues, ankesa e Operatorit Ekonomik,,AWA "Sh.p.k,Njoftimin për Kontratë, i datës 12.07.2023, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, i datës 15.09.2023, Raportin e Vlerësimit Tenderëve i datës 22.08.2023, për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Pajisje Elemente Sportive për Sallën Edukative Fizike në AKSP" me numër të prokurimit"214-23-7609-1-2-1"dhe Vendimin e |Autoritetit kontraktues për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, i datës, 22.09.2023.

Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Paneli shqyrtues konstaton se raporti ekspertit ka trajtuar pretendimet e operatorit ekonomik ankues, lidhur me mungesën e autorizimit të prodhuesit, që ka qenë dhe kërkese e Dosjes së tenderit, të cilën edhe vet OE ankues deklaron se nuk e ka dorëzuar me DT, derisa raporti ekspertit e vlerëson si të bazuar pretendimin ankimor, në kundërshtim me kërkesat e DT. Po ashtu raporti ekspertit shqyrtues e trajton edhe një pretendimin ankimor të OE ankues lidhur me mos prezantim të certifikatës ISO, derisa Paneli vrenë se OE ankues "AWA SH.p.k" është vlerësuar si i papërgjegjshëm sipas Raportit të vlerësimit të tenderëve, vetëm për një arsye, të mungese se autorizimit të prodhuesit dhe jo, për "certifikatë ISO" edhe AK në vendimin lidhur me Kërkesën për rishqyrtim të OE ankues, nuk ka trajtuar pretendim ankimor lidhur me certifikatën ISO. Njëashtu ankesa OE e paraqitur në OSHP nuk ka pretendim ankimor lidhur me ceritfikatë ISO, andaj dhe bazuar në konstatimet dhe argumentet e lartecekuara, Paneli nuk i falë besimin e provës raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues vëren se Autoriteti Kontraktues Akademia e Kosovës për Siguri Publike, sipas vendimit të datës 22.09.2023, në përgjigjen për OE ankues, e ka argumentuar refuzimin e pretendimeve ankimore, të cilat janë bindëse edhe për vete Panelin, i cili i falë besimin e provës. Autoriteti i konstaton se pala ankuese është e papërgjegjshme, dhe se OE i rekomanduar plotëson kërkesat e aktivitetit prokurimi. Vendimi i AK përgjigjja në kërkesën për rishqyrtim të OE ankues,AWA "Sh.p.k, si vijim:

"Përgjigjeje në pretendimin 1,2 dhe 3.AK-ja ka respektuar nenin 1 te LPP-se deri sa ka shpallur tenderin dhe ne baze te kësaj ka respektuar parimin e transparences dhe qëllimin e prokurimit dhe besojmë qe nuk ka pasur kurrfarë kufizimi te konkurrencës dhe kurrfarë ndikimi tjetër. Gjithashtu sa i përket parimin e shfrytëzimit sa me efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe te drejte te fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur procedurave dhe kushteve qenësore te këtij ligji. Sa i përket pretendimit te O.E. ,,AWA" se është shkelur neni 1 dhe 6 i LPP _se kjo nuk qëndron për faktin se nuk ka jep asnjë fakt apo deklarate mbi faktet se si është shkelur nenet 1 dhe 6 te pika 7 deklarate detale mbi faktet dhe argumentet. Ne baze te kësaj ne si A.K. mundemi me konkluduar se ky O.E. e ka si qellim vetëm neglizhimin e projektit tone. Bazuar ne sqarimet e cekura pretendimet ankimore janë plotësisht te pa bazuara.

Sa i përket pretendimit se është shkelur neni 52, 59,72 kjo nuk qëndron pasi ne kemi vlerësuar ne përputhje me ligjin e LPP-se dhe Rregulloren për Prokurim Publik. Në baze te LPP-se neni 59 .2 ,neni 72 nuk kemi pas çka te kërkojmë sqarime pasi për komisionin e vlerësimit ka qene e qarte se autorizimin nga prodhuesi qe ka qene kërkesë e FDT-se nuk e keni dërguar fare, pore

keni dërguar nje autorizim përfaqësimi nga pronari Ardonis Lipovica për personin Granit Berbatovci qe ta përfaqësoj firmën ne emër te tije e noterizuar nga noteri Fatmir Halimi.Bazuar ne sqarimet e cekura pretendimet ankimore janë plotësisht të pa bazuara.

Ndërsa sa i përket 9.Neni I0.1 i RRUPP nr, 001/2023- sqarimi i tenderëve gjate procesit te vlerësimit te tenderëve ku ceket po citoj; Është kërkuar autorizimi origjinal origjinal por është dorëzuar autorizimi i skanuar. Mund te kërkoni informata sqaruese sipas nenit 66.

Ju nuk keni dorëzuar fare ne oferte autorizimin nga prodhuesi qe ka qene kërkesë e FDT. dhe jeni eliminuar si i papërgjegjshëm. Ju si O.E. nuk keni interes materialo juridik por vetëm ta prolongoni procesin dhe vononi pa asnjë arsye ligjore"

Paneli shqyrtues po ashtu vëren se në Raportin e vlerësimit të tenderëve të Autoritetit Kontraktues, i datës 22.08.2023, janë vlerësuar të gjitha ofertat tenderuese dhe në faqen 9 të raportit vërehet shënimi lidhur me ofertën e operatorit ekonomik ankues, e cila është vlerësuar si ofertë e papërgjegjshme për shkak të mos dorëzimit të dokumenteve të kërkuara sipas Dosjes se tenderit, përkatësisht të mungesës se autorizimit te prodhuesit.

Po ashtu Paneli shqyrtues vëren se "AWA,.SH.p.k", nuk ka arritur te argumentojnë me asnjë dëshmi se është i përgjegjshëm dhe ka plotësuar të gjitha kërkesat e Dosjes se tenderit, por vet ka theksuar se në ofertën tij tenderuese nuk e ka pasur te bashkangjitur dokumentin, autorizim të prodhuesit, duke arsyetuar se Autoriteti kontraktues në bazë të nenit 72.3 të LPP, ka mund të kërkojnë informata plotësuese. Paneli shqyrtues lidhur me nenin 72 të LPP-së dhe dispozitat tjera të akteve nënligjore, për çështje të njëjtë se, Autoriteti kontraktues"...*mund të kërkojnë nga operatoret ekonomik të dorzojnë,plotësojnë*.." , është norme diskreticionale sipas vlerësimit, në procedurat e aktivitetit të prokurimit.

Paneli shqyrtues vëren se Autoriteti kontraktues ne Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, te datës, 15.09.2023, ankuesin e ka vlerësuar si të papërgjegjshëm dhe e ka eliminuar nga procesi i prokurimit për shkaqe te mungesës se dokumentit me arsyetim si ne vijim;*"AWA" SH.P.K është i pa përgjegjshëm pasi që sipas kërkesave te AK-s "*

Paneli shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit, andaj Paneli përfundimisht ka vendosur për të refuzuar ankesën e Operatorit ekonomik"Awa" Sh.p.k dhe mbetet në fuqi "Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues" datës, 15.09.2023, Akademia e Kosovës për Siguri Publike, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Pajisje Elemente Sportive për Sallën Edukative Fizike në AKSP" me numër të prokurimit "214-23-7609-1-2-1".

Paneli shqyrtues vendosi konfiskimin e mjetet të deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës, pasi ankesa e është refuzuar si e pabazuar e Operatorit Ekonomik "Awa" Sh.p.k, konform nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP-së dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Pa nevojë për analiza tjera të pretendimeve ankimore dhe provave tjera, OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore mirëpo AK duhet të kujdeset ex-officio edhe për parimet bazë të LPP-së.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE**
- OE - **AWA SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: